



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 913/ 10 prot.

Datë 02/05/2025

V E N D I M
Nr. 600/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 02/05/2025, mori në shqyrtim çështjen me,

Objekt: Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 531/2025, datë 22.04.2025 për procedurën e prokurimit “Procedura e hapur shërbim mbi kufirin e lartë monetar, Marrëveshje Kuadër me disa Operatorë Ekonomikë, me kushte të pa përcaktuara”, me Nr. REF-37091-02-07-2025, me objekt “Shërbimi i mbikëqyrjes së punimeve te ndertimit”, me fond limit 120,182,651 (njëqind e njëzet milion e njëqind e tetëdhjetë e dy mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e një) lekë pa TVSH ose 1,216,916.27 Euro, bazuar në kursin e këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë të datës 06.02.2025, ku 1 Euro këmbëhet 98.76 lek, zhvilluar më datë 03.03.2025, nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara.

Ankimues: Operatori ekonomik “Tower” SHPK me NIPT L21717003H me adresa: Rruga “Fadil Rada”, Pallati Daniela, Shk. 2, Kati. 3, Ap. 9, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor: Operatori i Blerjeve të Përqëndruara sh.a
Adresa: Rruga “Reshit Çollaku”, Godina Nr.6/337, (në krah të Gjykatës së Lartë), Tiranë.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për

Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për Miratimin e Rregullave për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datë 22.04.2025, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 531/2025, ku vendosi:

1. *Të mbyllë çështjen mbi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Tower” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedura e hapur shërbim mbi kufirin e lartë monetar, Marrëveshje Kuadër me disa Operatorë Ekonomikë, me kushte të pa përcaktuara”, me Nr. REF-37091-02-07-2025, me objekt “Shërbimi i mbikëqyrjes së punimeve të ndertimit”, me fond limit 120,182,651 (njëqind e njëzet milion e njëqind e tetëdhjetë e dy mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e një) lekë pa TVSH ose 1,216,916.27 Euro, bazuar në kursin e këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë të datës 06.02.2025, ku 1 Euro këmbëhet 98.76 lek, zhvilluar më datë 03.03.2025, nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara.*
2. *Autoriteti kontraktor të kryej rivlerësimin e procedurës në zbatim të vendimit të KSHA-së Nr. 21, datë 16.04.2025, dhe të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.*
3. *Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.*
4. *Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Tower” SHPK.*
5. *Kopje e këtij vendimi t’i dërgohet Agjencisë së Prokurimit Publik.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.2. Me shkresën nr. 1146/5 prot., datë 29.04.2025, me objekt “Njoftim mbi zbatimin e Vendimit”, protokolluar me tonën nr. 913/7 prot., datë 30.04.2025, autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqëndruara sh.a., lidhur me zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 531/2025, datë 22.04.2025, duke e rivlerësuar ofertën e operatorit ekonomik “Tower” Sh.P.K në procedurën e prokurimit “Procedura e hapur shërbim mbi kufirin e lartë monetar, Marrëveshje Kuadër me disa Operatorë Ekonomikë, me kushte të pa

përcaktuara”, me Nr. REF-37091-02-07-2025, me objekt “Shërbimi i mbikëqyrjes së punimeve te ndertimit”, me fond limit 120,182,651 (njëqind e njëzet milion e njëqind e tetëdhjetë e dy mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e një) lekë pa TVSH ose 1,216,916.27 Euro, bazuar në kursin e këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë të datës 06.02.2025, ku 1 Euro këmbëhet 98.76 lek, zhvilluar më datë 03.03.2025, nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton

II.1. Me shkresën nr. 1146/5 prot., datë 29.04.2025, me objekt *“Njoftim mbi zbatimin e Vendimit”,* protokolluar me tonën nr. 913/7 prot., datë 30.04.2025, autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqëndruara sh.a., lidhur me zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 531/2025, datë 22.04.2025, duke e rivlerësuar ofertën e operatorit ekonomik *“Tower” Sh.P.K* në procedurën e prokurimit *“Procedura e hapur shërbim mbi kufirin e lartë monetar, Marrëveshje Kuadër me disa Operatorë Ekonomikë, me kushte të pa përcaktuara”,* me Nr. REF-37091-02-07-2025, me objekt *“Shërbimi i mbikëqyrjes së punimeve te ndertimit”,* me fond limit 120,182,651 (njëqind e njëzet milion e njëqind e tetëdhjetë e dy mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e një) lekë pa TVSH ose 1,216,916.27 Euro, bazuar në kursin e këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë të datës 06.02.2025, ku 1 Euro këmbëhet 98.76 lek, zhvilluar më datë 03.03.2025, nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara.

Referuar shkresës së mësipërme, të dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik, Komisioni vëren se, autoriteti kontraktor nëpërmjetë shkresës së mësipërcituar ka dërguar pranë Komisionit Prokurimit Publik praktikën për zbatimin e vendimit nr. 531/2025 datë 22.04.2025, të KPP. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik dhe raport auditit KPP konstaton se autoriteti kontraktor ka kryer rivlersimin e procedurës duke rishikuar statusin operatorit ekonomik *“Tower” SHPK* ku nga i skualifikuar rezulton i kualifikuar. Ndaj në këto kushte, rezulton se autoriteti kontraktor ka marrë masat e nevojshme në zbatim të përcaktimeve të bëra në vendimin KPP 531/2025, datë 22.04.2025 për procedurën e prokurimit objekt ankimi.

Përsa më sipër, në mbështetje të ligjit nr. 162/2020 *“Për Prokurimin Publik”* i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,* i ndryshuar, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 *“Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”,* nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 *“Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”,* Komisioni i Prokurimit Publik, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “*Procedura e hapur shërbim mbi kufirin e lartë monetar, Marrëveshje Kuadër me disa Operatorë Ekonomikë, me kushte të pa përcaktuara*”, me Nr. REF-37091-02-07-2025, me objekt “*Shërbimi i mbikëqyrjes së punimeve të ndertimit*”, me fond limit 120,182,651 (njëqind e njëzet milion e njëqind e tetëdhjetë e dy mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e një) lekë pa TVSH ose 1,216,916.27 Euro, bazuar në kursin e këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë të datës 06.02.2025, ku 1 Euro këmbëhet 98.76 lek, zhvilluar më datë 03.03.2025, nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara.
2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Florent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Kryetar
Jonaid Myzyri

